



Gjendet i vdekur një 28-vjeçar në rrugën Mati 1, dyshohet të jetë vetëvrasë



27/07/2023 22:03



Një person dyshohet të jetë vetëvrasë, pasi është gjetur pa shenja jete në një veturë në rrugën “Sokol Sopi” të kryeqytetit.


Nga Policia e Kosovës konfirmuan se nga dyshimet e para ka të bëjë me vetëvrasje, porse duhet pritur ekzaminimet e mëtutjeshme, përcjell **lajmi.net**.

Në anën tjetër, mësohet se i ndjeri është i gjinisë mashkull dhe i moshës 28 vjeç.

“Rreth orës 21:00, kemi pranuar informatën për një trup të pajetë, në një veturë në rrugën “Sokol Sopi” në Prishtinë. Policia menjëherë ka dalë në vendin e ngjarjes si dhe ekipi i mjekëve emergjent të cilët kanë konstatuar vdekjen e viktimës, mashkull, rreth 28 vjeç. Përkundër që mbështetur në informacionet e para, dyshimet e ngritura sugjerojnë se bëhet fjalë për vetëvrasje, policia me kujdes të shtuar po vijon ndërmarrjen e të gjitha veprimeve hetimore dhe të ekzaminimit, me qëllim sqarimin e plotë të rrethanave të ngjarjes. Aktualisht policia në koordinim me prokurorin e shtetit ka nisur një hetim mbi vdekjen”, thuhet në raportin e policisë.

Lajmi.net pak kohë më parë solli te ju pamje ekskluzive nga vendi tragjik, pamje këto që mund t’i shihni edhe më poshtë.

LAJME TË FUNDIT



Putin i gatshëm të nis bisedimet e paqes me Ukrainën



Përfundon në mbeturina guri përkujtimor i Nënës Pashë




Mësohen ndeshjet e para të sezonit 2023/24 edhe në Ligën e Parë



Një serbi i ngritet aktakuzë për krime lufte

Artikuj të ngjashëm



July 28, 2023
Putin i gatshëm të nis bisedimet e paqes me Ukrainën



July 28, 2023
Përfundon në mbeturina guri përkujtimor i Nënës Pashë



July 28, 2023
Një serbi i ngritet aktakuzë për krime lufte



July 28, 2023
Tahiri: Anulimi i seancës i qëllimshëm për t’i ikur përgjegjësisë të...



July 28, 2023
“Vjosa për kurgjo s’o, Albini o i poshtër e háram vota...



July 28, 2023
Kurti drekon me “klanin” e ngushtë të partisë, Dejona Mihali në...